



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

URDHËR

Nr. 284 datë 01/05/2017

PËR

“KRYERJEN E INSPEKTIMEVE ON-LINE”

Në zbatim të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, shkresës me nr. 125 prot, datë 30.03.2017, nga kompania ikubINFO, e cila njofton se ka përfunduar implementimin në sistem të të gjithë dokumenteve standarde dhe listë-verifikimeve, për kryerjen e inspektimeve on-line nëpërmjet sistemit unik “e-Inspektimi”,

URDHËROJ

1. E gjithë veprimtaria inspektuese e Inspektorateve shtetërore/trupat e tjera inspektuese të kryhet on-line në sistemin “e-Inspektimi” nëpërmjet paketave portabël.
2. Grupet e inspektimit gjatë procesit inspektues pranë subjekteve, të identifikohen me kartën e dixhitalizuar të inspektorit, të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm.
3. Të kryejnë inspektimet on-line dhe të prodhojnë akte administrative në sistemin “e-Inspektimi”, Inspektoratet shtetërore/trupat e tjera inspektuese të listuar sa më poshtë:
 - ✓ Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
 - ✓ Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
 - ✓ Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve
 - ✓ Inspektorati Shtetëror i Ujërave
 - ✓ Inspektorati Shtetëror i Arsimit
 - ✓ Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
 - ✓ Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
 - ✓ Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

- ✓ Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
- ✓ Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
- ✓ Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Bujqësore dhe Veterinare
- ✓ Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës
- ✓ Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera
- ✓ Inspektorati Kombëtar i Mbikëqyrjes së Tregut

4. Mos kryerja dhe dokumentimi i veprimtarisë inspektuese on-line do të konsiderohet, si mospërmbushje e detyrimeve ligjore dhe do t'ju ngarkojë me përgjegjësi ligjore.
5. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

